

VENDIM
Nr. 503, datë 30.6.2026

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 607, DATË 27.10.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KALIMIN E MJEDISEVE TË NDËRTESES ‘GODINA E INOVACIONIT’ NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË AGJENCISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT (AKSHI)”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 607, datë 27.10.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin e mjediseve të ndërtesës ‘Godina e inovacionit’ në përgjegjësi administrimi të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Në katin e dytë (2), mjedisi me sipërfaqe 700 (shtatëqind) m² t’i jepet në përdorim pa shpërblim, për një afat të pacaktuar, shoqërisë “*Albanian Digital Solution*” sh.a., për ushtrimin e veprimtarisë administrative, sipas planimetrisë në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

b) Pas pikës 5 shtohet pika 5/1, me këtë përmbajtje:

“5/1. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe shoqëria “*Albanian Digital Solution*” sh.a. të lidhin marrëveshje për kushtet e përdorimit të mjediseve të përcaktuara në pikën 5 të këtij vendimi.”.

2. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, shoqëria “*Albanian Digital Solution*” sh.a., Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA 1
GODINA E INOVACIONIT
KATI DYTE (2)

